Gjurmime albanologjike
Seria e shkencave historike
54/2024

Eduard SHEHI
Instituti i Arkeologjisë
Akademia e Shkencave, Tiranë

SHËN ELEUTERIUS, DURRËSI DHE ETNONIMI "SHQIPTAR"

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Artikulli analizon lidhjen Durrësit me Shën Eleuterius sipas dorëshkrimeve "Rrëfime për 12 të Premtet" në sllavishte të hershme. Toponimi i qytetit ku ka ndodhur një debat mes shenjtit dhe një Hebreu jepet "Šeptail" (çereku tretë shek. XIII) ose "Drač" (shek. XIV). Rrënja e toponimit mendohet se ka qenë /*š*/-/*p*/-/*t*/-/*l*/. Një propozim për leximin e saj identifikon etnonimin "shqiptarë" sipas versionit sllav "*šiptar*".

Përmendja e Durrësit në dorëshkrimet fetare sllave lidhet me pozicionin kyç që ai zinte në përhapjen e krishterimit ndër sllavë që nga fundi i antikitetit të vonë. Falë këtij pozicioni gjen shpjegim edhe përdorimi i mundshëm i etnonimit "shqiptar" ose i rrënjës së fjalës prej së cilës mund të jetë krijuar më pas etnonimi. Përdorimi i toponimeve apo etnonimeve të lidhura me shqiptarët duket se kishte rolin e një garancie besueshmërie për dëgjuesit sllavë: "përderisa ngjarja kishte ndodhur në Durrës / në qytetin e atyre që dinin/ flisnin shqip, me siguri që ishte e vërtetë e duhej besuar".

Fjalët çelës: *Shën Eleuterius, Durrës, krishterimi ndër sllavë, etnonimi "shqiptar"*

Studimet mbi jetëshkrimet e shenjtorëve të krishterë dhe dokumentet fetare janë burime të rëndësishme për shqyrtimin e historisë dhe të kulturës së popullit shqiptar. Megjithatë, trajtimi i

tyre është sfidues për shkak të ndërthurjes së njohurive të ndryshme fetare, gjuhësore, historike dhe gjeografike. Në kërkimin tonë për të qartësuar historinë e qytetit të Durrësit përgjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës kemi vërejtur një mungesë të vëmendjes ndaj këtyre burimeve. Duke qenë se mes dokumenteve të tilla fetare mund të gjejmë të dhëna të rëndësishme historike, ne besojmë se është e rëndësishme të trajtohen aspektet që lidhin Durrësin me disa shenjtorë. Fillimisht, si një sprovë e parë, do të analizojmë lidhjet mes Shën Eleuterius (Eleutherius) dhe historisë e kulturës së qytetit në fjalë.

Në korpusin e Jetëshkrimeve të shenjtorëve njihen së paku 11 individë me emrin Eleuterius.[1] Në rastin tonë kemi të bëjmë me peshkopin-martir 20vjeçar të provincës romake Ilirikum. Sipas përmbledhjeve të Jetëshkrimeve të tij, ai u martirizua së bashku me të ëmën, Anthian, në kryeqytetin e Perandorisë, në Romë. Me urdhër të Perandorit Adrian të dy ata iu nënshtruan torturave dhe më pas atyre iu pre koka.[2] Reliktet u morën menjëherë nga besimtarët e peshkopit martir dhe u vendosën në dioqezën e tij, në provincën Ilirikum.

Sipas një tjetër versioni, e ëma e Eleuteriusit ishte nga Messina (Itali) ose nga Iliria dhe ishte konvertuar në të krishtere nga dishepujt e apostullit Paul në Romë. Zakonisht, në burimet latine, vendbanimi i saj lidhet me qytetin e Vlorës. Martirizimi i tyre ndodhi në vitet 117-120 në Romë.[3] Në ritin bizantin Shën Eleuteriusi i Ilirikumit festohet në datën 15 dhjetor, në ritin latin festohet më 18 prill, ndërsa në ritin e krishterë sirian më 26 mars.[4]

[1] Saint Augustine's Abbey, *The Book of Saints*, A&C Black: London, 1921, f. 90.

[2] Po aty, ku shkruhet se ishte i biri i konsullit romak Eugenius. Po ashtu, përmendet edhe versioni i transferimit të relikteve të tij në Kostandinopojë, ku u ndërtua më pas një kishë për nderin e një shenjti me të njëjtin emër. Për dallimin mes dy Eleuteriusve, atij të Kostandinopojës dhe të Ilirikumit, dhe të mbivendosjes së tyre ndër shekuj, shiko Basil Lourié, "Friday Veneration in Sixth-and Seventh-Century Christianity and Christian Legends about the Conversion of Naǧrān", në C. A. Segovia, *The Coming of the Comforter: When, Where, and to Whom? Studies on the Rise of Islam and Various Other Topics in Memory of John Wansbrough*, Georgias Press 2012, f. 181.

[3] Robert Elsie, *A Dictionary of Albanian Religion*, New York University Pres: New York, 2001, f. 10.

[4] B. Lourié, "Friday Veneration ...",f. 227.

Tek ky artikull ne nuk do të përqendrohemi tek Jetëshkrimi i Eleuterius-it, por në një tjetër tekst që lidhet me këtë shenjt. Dorëshkrimet e titulluara "Skazanie o 12 Pjatnicach", apo "Rrëfime për 12 të Premtet" janë një grupim tekstesh fetare që trajtojnë adhurimin e 12 të premteve të veçanta përgjatë vitit nga besimtarët e krishterë. Në traditën sllave ka dy versione të tij. Njëri, pagëzuar si versioni i Klementit, njihet gjerësisht edhe përtej botës sllave. Burimet që lidhen me të konsiderohen të vona nga studiuesit. Ndërsa versioni i dytë, që lidhet me emrin e Eleuteriusit, gjendet vetëm në botën sllave.[5] Ky tekst i dytë, sipas studiuesve, merr burimin e informacioneve nga ngjarje të Testamentit të Vjetër për të justifikuar adhurimin e 12 të premteve në fjalë. Referencat për këtë histori dhe lista e të premteve të shenjta hasen në disa dorëshkrime.[6] Përmbledhjet e "Rrëfimeve..." të Eleuteriusit ruhen në dorëshkrime në sllavishte të hershme, në një koleksion shkrimesh apokrife. E gjithë rrëfenja në fjalë ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë jepet përshkrimi i detajuar i një debati që ka ndodhur mes Eleuteriusit dhe një hebreu. Ndërsa pjesa e dytë paraqet një dokument të hamendësuar me origjinë apostolike, ku trajtohej rëndësia që kishin Dymbëdhjetë të Premtet dhe cilat ishin ato. Sipas historisë në fjalë, ky dokument u ishte fshehur të krishterëve nga hebrenjtë.[7]

Pjesa e parë e përmbledhjes së Eleuteriusit, e cila paraqet interes për ne, konsiderohet një punë origjinale që i ka rrënjët në dosjet jetëpërshkruese të shenjtorit dhe nënës së tij, Anthias. Sipas këtij teksti Eleuterius jetonte në provincën "Laura", në një qytet emri i të cilit

[5] Sergey Ivanov, "The Legend of the Twelve Fridays in the Russian and Irish Traditions: An Attempt at Contrastive Analysis", *Studia Celto-Slavica* 7, 2015, f. 105-116, f. 106.

[6] A. De Santos Otero, *Die Handschriftliche Überlieferung der Altslavischen Apokryphen*, band II, Walter de Gruyter: Berlin/New York, 1981, f. 224, ku jepen bashkë me një përmbledhje bibliografike të detajuar për burimet arkivore si dhe studimet e ndryshme mbi dorëshkrimet. Mbi një përmbledhje më të fundit të studimeve dhe të burimeve arkivore, duke shtuar edhe dorëshkrime që mungojnë te botimi i mësipërm, shiko A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts with fluctuating traditions: the casse of the South Slavonic Copies of 'The account of the Twelve Fridays'", në L.M.E. Sels, J. Fuchsbauer, V.S. Tomelleri (bot.), *Editing medieval texts from a differnt angle. Slavonic and multilingual traditions ...,* Leuven 2018, f. 349, cit. 1.

[7] A. De Santos Otero, *Die Handschriftliche* ..., f. 224; B. Lourié, "Friday Veneration...", f. 146-147.

paraqitet me tri variante, siç do ta shikojmë në vazhdim. Në këtë qytet jetonin shumë hebrenj, të cilët kishin zënka të vazhdueshme me të krishterët në treg, në rrugë apo edhe në portat e qytetit. Duke qenë se situata ishte bërë e vështirë dhe me qëllimin e ndalimit të përplasjeve të vazhdueshme mes banorëve, mes dy grupeve fetare u dakortësua që dy të përzgjidhej nga një filozof prej secilës palë, të cilët do të debatonin mes tyre. Hebrenjtë premtuan se nëse filozofi i krishterë do të shpallej fitues, ato do të konvertoheshin. Të krishterët zgjodhën një njeri besimtar, me emrin Eleuterius, ndërsa hebrenjtë zgjodhën njëfarë Tarasius. Sipas rrëfenjës, pas shumë debatesh dhe në asamblenë e tretë, me ndihmën e perëndisë, Eleuterius arriti të fitonte debatin. Më pas rrëfimi tregon se pas kësaj fitoreje, hebreu Tarasius i bëri të njohur Eleuteriusit ekzistencën e një dokumenti apostolik, të quajtur "Dymbëdhjetë të Premtet", i cili u ishte mbajtur i fshehtë të krishterëve. Pjesa e dytë e tekstit i dedikohet pikërisht këtij dokumenti të pretenduar apostolik, paraqitjes së listës së këtyre të premteve dhe arsyeve përse duheshin adhuruar.[8]

Dorëshkrimet më të vjetra të "Rrëfenjave …", të shkruara në sllavishte të hershme, fillojnë që nga fundi i shek. XII, me disa variante të mëvonshme deri në shek. XVIII; njihet gjithashtu edhe një dorëshkrim në rusishte i shek. XV.[9] Tek këto dorëshkrime toponimi i provincës ku zhvillohen ngjarjet jepet në formën "Laura" (Λαουρα)[10], me disa deformime në dorëshkrimet e më vona. Ndërsa toponimi i qytetit ku zhvillohen ngjarjet jepet në tri versione:

- Mungon tërësisht përmendja e toponimit të qytetit. Dorëshkrimi më i hershëm me këtë version i takon fundit të shek. XII – fillimit të shek. XIII[11];

[8] B. Lourié, "Friday Veneration …", f. 166-167; Basil Lourié, "Slavonic Pseudepigrapha, Nubia, and the Syrians", në T. Nicklas, C. R. Moss, C. M. Tuckett, J. Verheyden (bot.), *The Other Side: Apocryphal Perspectives on Ancient Christian "Orthodoxies"*, *Novum Testamentum et Orbis Antiquus 117,* Göttingen: V&R 2017, f. 243; A. Miltenova, A.Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts …", f. 353.

[9] Shiko më lart citimin nr. 6 si edhe B. Lourié, "Friday Veneration …",f. 165, cit. 72.

[10] Te dorëshkrimi më i hershëm, i fundshek. XII - fillimshek. XIII, shiko A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts …", f. 369, Dorëshkrimi nr. 34 në Manastirin e Shën Katerinës në Malin Sinai.

[11] A. Miltenova, A.Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts …", f. 369, Dorëshkrimi nr. 34 në Manastirin e Shën Katerinës në Malin Sinai.

- Toponimi i qytetit jepet në formën "Šeptail". Dorëshkrimi më i hershëm me këtë version i takon çerekut të tretë të shek. XIII.[12] Në dorëshkrime më të vona hasen deformime të këtij toponimi;
- Toponimi i qytetit shkruhet "Drač" (versioni sllav për qytetin e Durrësit). Dorëshkrimi më i hershëm me këtë version i takon shek. XIV.[13]

Mbi origjinën e dorëshkrimeve origjinale, ku janë bazuar dorëshkrimet sllave, janë hedhur dy mendime të kundërta nga studiuesit e fushës. Versioni i parë shikon aty ndikime të qarta të një teksti origjinal të shkruar në gjuhën e hershme siriane (njohur edhe si Siriak, gjuha asiriane, apo sirian aramaic, pjesë e gjuhëve aramaike). Momenti i kalimit nga versioni sirian në sllavishte të hershme vlerësohet se ka ndodhur pak kohë para viteve 680-690. Sipas këtij versioni, tekstet origjinale ishin pjesë e predikimeve të krishtera siriane ndër popullsitë arabe, pothuaj njëqind vite më herët. Te dorëshkrimet në sllavishte të hershme duhet parë një transformim dhe përkthim i përshtatur i tekstit origjinal, me qëllimin për t'u predikuar tek sllavët.[14] Në këtë formë, dosja origjinale e historisë së Eleuteriusit (e destinuar për arabët), duhet të lidhet me rrymat fetare monofizite të shek. VI, e ndoshta pjesërisht të përbashkëta me rrymën kalcedonase. Ndërsa tekstet derivate në sllavishte të hershme janë konsideruar pjesë e misioneve të krishtera monofizite siriane për përhapjen e mësimeve anti-kalcedonase në shek. VII ndër popujt sllavë.[15]

Mendimi i dytë lidhur me origjinën e dorëshkrimeve sllave të "Rrëfenjave..." na shfaqet tërësisht i kundërt me versionin e parë. Në studime të mëvonshme, ideja e hedhur nga B. Luorié mbi origjinën siriake të dorëshkrimeve sllave është hedhur tërësisht poshtë. Dy nga studiuesit më të njohur të fushës e quajnë të pambështetur analizën

[12] B. Lourié, "Friday Veneration ...", f. 175; A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts ...", f. 369, Dorëshkrimi nr. 651 i Bibliotekës Kombëtare Serbe në Beograd.

[13] A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts ...", f. 369, Dorëshkrimi nr. 300 i Bibliotekës Kombëtare Serbe në Beograd.

[14] B. Lourié, "Slavonic Pseudepigrapha...", f. 243.

[15] B. Lourié, "Friday Veneration ...",f. 167-168.

e B. Lourié të evolucionit të termave të përdorura, që ndërlidh fjalët sllave me gjuhën siriane të hershme.[16] Si bazë e dorëshkrimeve sllave (e për rrjedhojë e toponimisë së përdorur në to), nga përfaqësuesit e këtij mendimi të dytë, është parë një origjinë nga tekstet latine dhe jo siriake.[17]

Pavarësisht nga vlerësimet mbi origjinën, se ku janë mbështetur dorëshkrimet në sllavishte të hershme, për ne kanë rëndësi toponimet e përdorura në to. Prandaj, pavarësisht mendimeve të ndryshme, mundemi lirshëm të trajtojmë më tej këtë aspekt për të cilën kemi më shumë interes.

Sipas studiuesit B. Lourié toponimi i provincës "Laura" (Λαουρα) duhet parë si një transliterim në sllavisht i një fjale siriake. Ky toponim haset në dorëshkrimet më të hershme sllave dhe derivate të tij janë të pranishme në të tjerë dorëshkrime të shek. XVI dhe XVIII.[18] Sipas studiuesit në fjalë, toponimi Ιλλυρικόν në pasazhin Romakët 15:19, të versionit të Biblës në gjuhën peshite, është transliteruar `*lwrqwn*. Ndërsa për formën Ιλλυρία ai shprehet se transliterimi duhej të ishte `*lwry'*. Për rrjedhojë, Lourié shprehet i bindur se toponimi "Laura" duhet parë si një transliterim nga origjinali asiras në sllavishte të hershme të toponimit të provincës Ilirikum.[19] Këto shpjegime e vendosin toponimin e përdorur me origjinë që nga shek. VI-VII dhe të përdorur sipas origjinalit siriak në tekstet sllave.

Dy studiuesit që nuk pranojnë origjinën siriake të tekstit fillestar nuk e kanë trajtuar aspektin e toponimisë dhe të kuptimit që ka pasur emri i provincës. Për rrjedhojë nuk mund të bëjmë një krahasim mes tyre.

Emri i qytetit në traditën e dorëshkrimeve sllave, siç e përmendëm më lart, haset në tri versione: mungon tërësisht toponimi i qytetit; toponimi jepet "Šeptail"; toponimi jepet "Drač". Versionet e

[16]A. Miltenova, A.Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts …",f. 362.

[17] Sergey V. Ivanov, "The Legend of the Twelve Fridays and 'Quattuor Tempora'", *Scrinium* 9, 2013, f. 186, 202; Sergey Ivanov, "Anti-Jewish polemics and the texts on Friday fasts", *Literaturwissenschaftliches Jahrbuch* 57, 2016, f. 105.

[18] B. Lourié, "Friday Veneration …", f. 173, cit. 82. A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts …", f. 357, i shton listës edhe disa deformime që ka pësuar toponimi në dorëshkrime të mëvona.

[19] B. Lourié, "Friday Veneration …", f. 174.

dorëshkrimeve që lidhen me toponimin "*Šeptail*" renditen si më poshtë nga B. Lourié:[20]

- Шепъталъ (*Šep"tal"*) – dorëshkrimi i njohur me emërtimin T1.
- Шипѣль (*Šipēl'*) – përdorur në dy dorëshkrime: ai i identifikuar nga B. Lourié si "Sokolov ms"[21] dhe "ms nr. 53" e Miltenova-s.
- Шиньталь (*Šin'tal'*) – përdorur në dy dorëshkrime të shek. XVI dhe XVII (njohur si Vienna 149; Adzharski 326).
- Щпалъ (*Ščpal"*) – përdorur në dorëshkrimin e emërtuar Унδ.

Një tjetër dorëshkrim rusisht, i njohur si T2, i shek. XVI, ka rezultuar me një gabim në transliterimin e fjalës.

Basil Lourié shprehet se toponimi origjinal i qytetit, bazuar në analizën gjuhësore të versioneve të ruajtura në sllavisht, duke marrë në konsideratë praninë apo mungesën e germave, si dhe evolucionin e rregullave gjuhësore të sllavishtes, ka pasur si rrënjë bashkëtingëlloret /*š*/-/*p*/-/*t*/-/*l*/.[22] Për leximin e fjalës fillestare me këtë rrënjë janë propozuar dy mundësi prej tij, që do të shpjegonin kuptimin e toponimit të përdorur në dorëshkrimet sllave.

Mundësia e parë do të ishte fjala siriake *šābtāyē*[23] në kuptimin e σαββατιανοί (*Sabbatarians*), apo "heretikë që respektonin *sabbathum* hebraik".[24] Lourié jep edhe disa arsyetime gjuhësore për të shpjeguar transformimin e fjalës, duke analizuar aspektet e gjuhëve të hershme asirase dhe sllave. Në një hipotezë të tillë, termi i dorëshkrimit sllavisht "*Šeptail*" nuk do të ishte më toponimi i qytetit, por një tregues i qytetit ku jetonin sabatarët. Në këtë formë hamendësohet se

[20] B. Lourié, "Friday Veneration ...", f. 175.

[21] I cili në fakt vlerësohet si dorëshkrimi më i vjetër prej B. Louiré. A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts ...", f. 352, 360, japin si mbishkrimin më të hershëm "Mount Sinai, nr. 34" datuar në fundin e shek. XII-fillimin e shek. XIII, ku lexohet toponimi Laoura, por nuk jepet emri i qytetit. Mbishkrimi tjetër, nr. 61 i Bibliotekës Kombëtare Serbe në Beograd, datuar në çerekun e fundit të shek. XIII, është ai që Lourié e cilëson si "Sokolov ms".

[22] B. Lourié, "Friday Veneration ...", f. 176.

[23] B. Lourié, "Friday Veneration ...", f. 176.

[24] Robert Payne Smith, *Thesaurus Syriacus*, tomus II, Oranii 1901, kol. 4049.

me sabatarët identifikohej një grup i caktuar i popullsisë, i ndryshëm nga të tjerët, në rastin konkret hebrenjtë. Në këtë formë, sipas Lourié, ka shumë mundësi, por jo absolutisht e sigurt, se bëhej fjalë për qytetin e Durrësit.[25] Pra ngjarjet zhvilloheshin në qytetin ku jetonin besimtarët hebrenj që respektonin sabatin, në Durrës.

Mundësia e dytë, por që Lourié nuk e ka analizuar më tej në studimin e tij, paraqet një drejtim tërësisht të ndryshëm të shpjegimit të fjalës. Sipas këtij versioni te rrënja e fjalës së ruajtur në bashkëtingëlloret /*š*/-/*p*/-/*t*/-/*l*/ vihet re ndikimi nga sllavishtja jugore. Kështu, kjo fjalë identifikon etnonimin shqiptar sipas versionit sllav "*šiptar*".[26] Emërtim ky që, siç e dimë tashmë, në kohët moderne ka marrë nënkuptim përçmues. Rrënja e kësaj fjale në versionin sllav vjen nga shqipja "*shqipe*", sipas një forme arkaike "шћипетар" (*ščipetar*). Deri më sot, datimi më i hershëm që kanë gjetur gjuhëtarët për përdorimin e etnonimit "shqiptar" është hasur në një dokument të finalizuar në vitin 1652, në formën "schiepatar". Përdorimi në tekstin në fjalë rezulton të ketë pasur kuptimin "ky që di gjuhën". Prandaj, autori i studimit arrin në përfundimin se emërtimi "shqiptar" kishte kuptimin e përgjithshëm "njohës dhe zotërues i shqipes, shqipfolës", së paku qysh në gjysmën e parë të shek. XVII.[27]

Studiuesit e grupit të dytë, që e shikojnë origjinën e dorëshkrimeve sllavishte tek ato latine, nuk shprehen mbi toponiminë e përdorur. Ndërkohë, nëse marrim parasysh mendimin e tyre, duke hedhur poshtë origjinën siriake të tekstit origjinal, duhet të hidhet poshtë edhe interpretimi i origjinës së fjalës me rrënjë bashkëtingëlloret /*š*/-/*p*/-/*t*/-/*l*/, që e lidh me "sabatarët". Do të mbeteshim kështu vetëm me mundësinë e dytë, atë që e lidh me shqiptarët.

Siç e përmendëm, në dorëshkrimin më të hershëm, të fundit të shek. XII – fillimit të shek. XIII, përmendet vetëm toponimi i provincës, por jo qyteti. Datimi më i hershëm i fjalës që mund të

[25] B. Lourié, "Friday Veneration …", f. 176.
[26] B. Lourié, "Friday Veneration …", f. 176.
[27] Bardhyl Demiraj, "Shqiptar në një dorëshkrim të shek. XVII", *Shejzat* 1-2, 2022, f. 7-19.

lidhet me etnonimin "shqiptar" i takon çerekut të tretë të shek. XIII[28], pasuar nga toponimi "Drač" në shek. XIV.[29]

* * *

Analizat e kundërta mbi origjinën e dorëshkrimeve sllavishte nuk e ulin rëndësinë që na paraqesin tekstet e "Rrëfenjave..." të Eleuterius-it. Falë tyre kemi të ruajtura ndër shekuj dy të dhëna me shumë rëndësi për historiografinë shqiptare. Elementi i parë lidhet me rolin që kishte qyteti i Durrësit përgjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në rajon dhe përse është shquar nga predikuesit fetarë që kanë shkruar këto dorëshkrime. Ndonëse një trajtim i tillë duket shumë lokal në pamje të parë, qartësisht përbën një faktor të rëndësishëm për të shtjelluar elementin pasues, siç do ta shikojmë më tej.

Në antikitetin e vonë dhe mesjetën e hershme, në territorin që përkon sot me Shqipërinë, kishat u administruan nga Roma deri në vitin 732. Provinca kishtare e Durrësit kishte të njëjtët kufij si provinca administrative e Epirit të Ri.[30] Që nga ky vit perandori bizantin Leoni III Isauri i shkëputi kishat e këtij territori dhe i vendosi në varësi të Patrikanës së Kostandinopojës.[31] Në përgjithësi, të dhënat arkivore lidhur me çështjet kishtare janë të pakta për shek. VII-VIII.

[28] B. Lourié, "Friday Veneration ...", f. 175; A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts ...", f. 369, Dorëshkrimi nr. 651 i Bibliotekës Kombëtare Serbe në Beograd.

[29] A. Miltenova, A. Angusheva-Tihanov, "Editing slavonic texts ...", f. 369, Dorëshkrimi nr. 300 i Bibliotekës Kombëtare Serbe në Beograd.

[30] Daniele Farlati, Jacopo Coleti, *Illyrici sacri. Tomus VII. Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis, et Sirmiensis, cum earum suffraganeis*, Venettis: Sebastianum Coleti, 1817, f. 339. Mbi provincën e Epirit të Ri shiko Malalas XIII, 11-13, si dhe Procop. *Vand*. III, I, 14-18.

[31] M. v. Šufflay, "Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme", në L. von Thallózy, (bot.), *Illyrisch – Albanische Forschungen*, vol. I, München-Leipzig 1916, f. 194 dhe bibliografia e cituar prej tij; Giorgio Fedalto, *Acta Eugenii Papae IV (1431-1447), e Vaticanis Aliisque Regestis Collegit Notisque Illustravit*. Fontes, Series III, Volumen XV, Romae 1990, f. 49.

Ato cekin kryesisht pjesëmarrjen e peshkopëve të Durrësit në koncilet kishtare të organizuara në Kostandinopojë (vitet 691 dhe 787).[32]

Krijimi i sistemit të *themave* nga Perandoria Bizantine, ku Durrësi u bë qendra e njërës prej tyre[33], solli edhe një riorganizim të kishave. U krijuan disa peshkopata të reja, ndërsa Durrësi vazhdoi të funksionojë si peshkopatë, prej së cilës vareshin disa peshkopata fqinje të sapokrijuara. Njihet ndër historianë fakti se Metropolia e Durrësit ka luajtur një rol aktiv në kristianizimin e sllavëve, veçanërisht në Doklea.[34] Informacione me rëndësi përcjellin pjesëmarrjet në koncile (si i ai vitit 879)[35], si dhe *Notitiae* e Leonit VI

[32] Lajos Thalloczy, Constantin Jireček, *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, Annos 344-1343, Vol. I (Vindobona: Typis Adolphi Holzhausen, 1913) (më tej: *AAlb*I),dok. nr. 49, 51.

[33] Nikolas Oikonomides, *Les listes de préséance byzantine des IXe et Xe siècles. Introduction, texte, traduction et commentaire*, Paris: Editions du Centre National de la Recherche Scientifiques, 1972, f. 46-47, shprehet se duhet të jetë krijuar në vitet 842-843; Jadran Ferluga, *Byzantium on the Balkans. Studies on the Byzantine Administration and the Southern Slavs from the VIIth to the XIIth Centuries*, Amsterdam: A. M. Hakkert, 1976, f. 215-224, mendon për periudhën në mes të viteve 802-811; Alain Ducellier, *La façade maritime de Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XIe siecle au XVe siècle,* Institute for Balkan Studies, monograph 117, Thessalonike, 1981, f. 92, cit. nr. 1, shkruan para vitit 827; John W. Nesbit, Nicolas Oikonomides, *Catalogue of Byzantine seals at Dumbarton Oaks and in the Fogg Museum of Art I. Italy, North of the Balkans, North of the Black Sea*, Washington, 1991, f. 40, vlerësojnë për një themelim në fillimin e shek. IX apo disa dhjetëvjeçarë para vitit 859; John V. A. Fine, *The Early Medieval Balkans. A Critical Survey from the Sixth to the Late Twelfth Century*, Ann Arbor: University of Michigan Press, 1991, f. 253, në dhjetëvjeçarin e parë të shek. IX; Treadgold, Warren T. *Byzantium and Its Army*, Stanford, California: Stanford University Press, 1995, f. 66, 69, e daton në vitin 840; Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar I. Ilirët, mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX*, Tiranë: Toena, 2002, f. 215 (nga tani e tutje *Historia* I), shkruan për një terminus ante quem 826; Vivient Prigent, "Notes sur l'évolution de l'administration byzantine en Adriatique (VIIIe-IXe siècle)", *Mélanges de l'École française de Rome. Moyen Âge*, 120/2, 2008, f. 408, shkruan se viti 815 është terminus ante quem; Tibor Živković, "Uspenskij's Taktikon and the Theme of Dalmatia", *Byzantina Symmeikta* 17, 2005, f. . 84, e vendos jo më vonë sesa vitet 811/812.

[34] Francis Dvornik, *The slavs, their early history and civilization*, Boston: American Academy of Arts and Sciences, 1959, f. 279.

[35] *AAlb* I, dok. nr. 57.

(902-907).[36] Për fundin e shek. X, në *Notitia*-n e Jan Cimishit, përmenden në varësi të metropolisë së Durrësit 15 peshkopata veriore dhe jugore në territorin e Ballkanit. Në këto vite kemi edhe shtrirjen më të madhe të kësaj province përgjatë mesjetës së hershme.[37]

Me rënien e Mbretërisë Bullgare, sipas diplomave të Vasilit II (1019-1020), organizimi kishtar pësoi disa transformime. Argjipeshkvia e Ohrit u fuqizua e u zgjerua në dëm të Argjipeshkvisë së Durrësit, duke i hequr asaj disa territore, konfirmuar zyrtarisht në vitin 1020 nga ana e perandorit Vasili II.[38] Më 1022 Roma i shkëputi Durrësit edhe dy provinca veriore, Tivarin e Ulqinin.[39] Një situatë e tillë duhet të ketë vazhduar për Durrësin, me pak ndryshime, deri në shek. XIII-XIV.[40]

Duke qenë se Mitropolia e Durrësit kishte ndihmuar në kristianizimin e Dokleas, konkurronte me Argjipeshkvitë e Ohrit dhe Splitit për juridiksion mbi kishat serbe. Rreth vitit 1066, me kërkesë të mbretit të Dokleas, Mihalit (i biri i Vojislavit), papa Aleksandër II krijoi Arkidioqezën Metropolitane latine të Dokleas në Tivar, duke e shtrirë juridiksionin te disa nga kishat që vareshin më parë nga Durrësi.[41]

Ndërsa nga pikëpamja historike, qyteti dhe territori i Durrësit kishin ndryshuar disa herë kontrollin politik, duke kaluar nën drejtimin e fuqive të ndryshme sovrane, mes bizantinëve, sllavëve, latinëve, apo edhe vendasve.[42] Këto mbivendosje pushtetesh politike janë shoqëruar edhe me ndërrimin e orientimeve fetare nën ndikimin

[36] Michel Le Quiens, "Oriens Christianus", në *Quatuor Patriarchatus Digestus,* tomus secundus, Parisiis 1740, f. 241.

[37] Milan von Šufflay, "Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme", në Thallózy, Ludwig von. 1916 (botues), *Illyrisch – Albanische Forschungen*, vol. I, München-Leipzig 1916, f. 197.

[38] M.von Šufflay, "Die Kirchenzustände…", f. 198.

[39] *AAlb* I, dok. nr. 40, 68, 116.

[40] M.von Šufflay, "Die Kirchenzustände…", f. 209-219.

[41] Martin Dimnik, "Kievan Rus', the Bulgars and the Southern Slavs, c. 1020-c.1200", në D. Luscombe, J. Riley-Smith (bot.), *The New Cambridge Medieval History. Vol. IV c. 1024-c. 1198. Part II*. Cambridge: Cambridge University Press, 2004, f. 267-268.

[42] Mbi një përmbledhje botuar së fundmi mbi historinë mesjetare të Durrësit, shiko Eduard Shehi, *Topografia e Durrësit mesjetar*, Akademia e Studimeve Albanologjike: Tiranë, 2022, f. 53.101.

herë të Kostandinopojës e herë të Romës. Të tilla ndryshime të shpeshta politike e fetare kanë lënë gjurmët e tyre në shumë sfera të tjera të jetës. Kisha e Durrësit dhe e territorit të tij ishte gjetur kështu në një kryqëzim mes dy botëve, mes Lindjes dhe Perëndimit. Kjo përballje konfirmohet në forma të ndryshme ndërveprimi, si në nivelin institucional, ashtu edhe individual. Në aspektin fetar, kemi dokumente ku na bëhen të njohur priftërinj me origjinë nga Durrësi e prapatoka e tij, që shfaqen në pozicionin e ndërmjetësve mes dy botëve. Po përmendim vetëm një rast që na përshtatet me temën që po trajtojmë. Në dokumentet historike të mesjetës së hershme përmendet prifti Pjetër nga Durrësi si përkthyesi nga greqishtja në latinishte e jetës së Shenjtores Arthelais.[43]

Një tjetër aspekt me interes është koncepti gjeografik për territorin në fjalë dhe forma se si shikoj e interpretohej nga burimet e kohës. Kështu, K. Porfirogjeneti përfshinte nën emërtimin "Durrës" pjesën më të madhe të territoreve shqiptare.[44] Ndërsa Theofilakti i Ohrit përdorte toponimin "malet e Durrësit"[45] në një formë të tillë që është cilësuar si një koncept me nuanca etnike.[46]

Për sa më sipër, është më se e qartë se qyteti i Durrësit zinte një pozicion kyç në përpjekjet e kishës për përhapjen e krishterimit ndër sllavë. Mitropolia e Durrësit ishte në një përballje të vazhdueshme me strukturat e tjera rajonale për shtrirje ndikimi në territor. Pikërisht te ky pozicion, si një bazë për misionet fetare të përhapjes së krishterimit, duhen parë edhe rrënjët e përmendjes së Durrësit me emër të përveçëm në tekstet sllave, apo me identifikimin e tij edhe kur nuk përmendet toponimi specifik. Pikërisht këtu, te roli historik

[43] Riccardo Valli, *Vita et obitus beate Arthellays uirginis. Testo, traduzione, commento*, Centro Culturale per lo studio della civiltà contadina nel Sannio: Campolattaro, 2019, f. 8.

[44] Porphyro. *De administrando,* 30/9, 96.

[45] P. Gautier (përkth.), *Théophylacte d'Achrida, Lettres*, Thessalonique: Association de recherches byzantines, 1986,120.32: "*Toute la région d'Achrida est remplie d'effroi et le territoire de Mokros - Mokros est un district d'Achrida – est ravagé par l'esclave et le rebelle. Bagora – c'est une très grande montagne, sise entre les montagnes de Bulgarie et celles de Dyrrachium – est aux mains du rebelle, et, pour tout dire, le mal s'appuie de tous côtés sur le mal."*

[46] Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Një studim mbi Shqipërinë e shek. XI-XVI*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 6.

i qytetit si një nga qendrat kishtare nga ku niseshin misionet fetare ndër sllave, duhet kërkuar arsyeja e përmendjes së tij në dorëshkrimet sllave të jetëve të lidhura me disa shenjtorë, që nuk gjejnë paralele në dorëshkrime latine apo në greqishte. Kjo logjikë vlen edhe për "Rrëfenjat..." e Eleuterius-it. Në këtë rast, dy versionet e përdorimit të toponimit na japin jo vetëm drejtpërdrejt qytetin, por ndoshta edhe identifikimin e qytetit me shqiptarët mesjetarë, në kuptime të ndërthurura, sipas kontekstit të çështjes që përcillej tek lexuesi.

Për sa më sipër na shfaqet qartësisht roli që kishte marrë Durrësi, si njëra nga qendrat kryesore misionare krishteruese ndër sllavë, qofshin këta misionarë monofizitë sirianë, sipas interpretimit të B. Lourié, apo edhe të ndikimeve fetare të ardhura nga bota latine sipas interpretimit të dytë. Nga këtu niseshin klerikët për të predikuar ndër fiset sllave në thellësi të Ballkanit, sigurisht që të pajisur me dorëshkrime ku përcilleshin mësimet fetare në gjuhën e popullsive të synuara. Përmendja e mundshme në to e provincës së Ilirikumit vlerësohej se kishte rëndësi simbolike fetare, si një vend ku kishin shkuar misionarët më të zellshëm.[47] Nëse do ndiqnim versionin e origjinës siriane, nën mbështetjen e rrymave lokale monofizite, predikuesit sirianë mund të kenë gjetur një bazë të mirë mbështetëse nga ku të zgjeronin aktivitetin e tyre. Pjesë e misioneve duhej të ishin edhe përkthimet në sllavishte nga origjinalet asirase, përfshirë edhe tekstet e cituara më lart. Në versionin tjetër, atë të origjinës latine të dorëshkrimeve, Durrësi do të shfaqej në një pozicion edhe më të favorshëm dhe më të besueshëm. Në fakt, lidhjet e shumta kulturore, politike e ekonomike që qyteti ka zhvilluar mes dy botëve, siç dëshmohet vazhdimisht nga burimet historike, e bëjnë shumë më bindës rolin e tij si ndërmjetës të rrymave fetare e përcjelljes së jetëshkrimeve të shenjtëve e dokumenteve të tjera fetare latine drejt sllavëve.

Pikërisht me këto situata dhe pozicionin e Durrësit lidhet edhe elementi i dytë që na përcillet nga dorëshkrimet sllave, me shumë rëndësi për historiografinë tonë: përdorimi i mundshëm i etnonimit si tregues i qytetit. Rrënja e mbijetuar e kësaj fjale transmetohet nga bashkëtingëlloret /*š*/-/*p*/-/*t*/-/*l*/ sipas B. Lourié. Versioni i dytë i shpjegimit të saj e lidh si identifikues të etnonimit të popullsisë lokale

[47] B. Lourié, "Friday Veneration ...", f. 228.

të Durrësit e të rrethinave. Koncept ky që do të na ngjasonte me formën se si K. Porfirogjeneti dhe Theofilakti i Ohrit përdornin toponimin e Durrësit si tregues për një territor më të gjerë. Në dorëshkrimet sllave do të kishim kështu shkëmbimin e mundshëm mes etnonimit dhe toponimit nga një dorëshkrim në tjetrin përgjatë shekujve, ku do të kuptohej si "qyteti i shqipfolësve".

Për sa më sipër, në versionin e një origjine latine mbi të cilat janë mbështetur dorëshkrimet sllave, do të mbetej i paqartë kuptimi i toponimit të provincës "Laura", por origjina e mundshme nga Illyrikum (apo versione të tjera të saj), duket e mundur. Forma e ndryshimit dhe rregullat gjuhësore të cilave i është nënshtruar ky toponim mbetet të sqarohen. Nga ana tjetër, tek origjina latine e dorëshkrimeve do të kishim një bazë edhe më të fortë për të kërkuar përdorimin më të hershëm të rrënjës së fjalës prej së cilës mund të jetë krijuar më pas etnonimi "shqiptar" në çerekun e tretë të shek. XIII, pasi qyteti i Durrësit ishte kthyer në një pikë kyçe në raportet mes Lindjes e Perëndimit. Një shekull më pas në të tjera dorëshkrime është zëvendësuar kjo fjalë me përdorimin e toponimit "Durrës". Në këtë shpjegim, datimi më i hershëm në çerekun e tretë shek. XIII do të për bënte një kufi kohor ante quem për përdorimin e mundshëm të fjalës me bashkëtingëlloret /*š*/-/*p*/-/*t*/-/*l*/.

Në aspektin gjuhësor ne nuk mund të bëjmë një analizë mbi këtë çështje, pasi u takon gjuhëtarëve për ta gjurmuar e qartësuar më tej. Megjithëse rrugëtimi për një sqarim të tillë do të ishte jo pak i mundimshëm, rezultati do të përbënte një vlerë të veçantë për historiografinë tonë. Duke parë historikisht rolin e Durrësit, jemi të mendimit se ekzistojnë të gjitha mundësitë që dorëshkrimet sllave të na përcjellin fjalën më të hershme që ka sjellë krijimin e etnonimit "shqiptar" edhe më herët sesa shek. XVII, që përbën kufirin më të poshtëm të njohur deri më sot. Si qendër administrative e provincës Epirus Nova, pasuar nga Thema e Durrësit, qyteti ishte seli administrative dhe ushtarake, e njëkohësisht edhe seli peshkopale, duke marrë kështu rëndësi të veçantë për Perandorinë Bizantine në Ballkan. Duke qenë pikërisht baza nga ku niseshin misionet fetare me detyrë predikimin e krishterë ndër sllavët paganë, e njëkohësisht nën ndikimin sa të Romës po aq edhe të Kostandinopojës, nuk do të përbënte habi që në dorëshkrimet sllave të vendoseshin toponime që

lidhen me identifikime etnike dhe territoriale të popullatës që e banonte atë. Një element i tillë duhej të mbështetej në traditën e kohës, duke përdorur kështu efektin e pritshmërisë: sllavët ishin mësuar me rolin që kishte Durrësi dhe ardhjen e predikuesve nga ky qytet. Për rrjedhojë predikimet bëheshin më të besueshme dhe më të pranueshme. Mendojmë se qëllimi i vendosjes së toponimeve apo të etnonimeve të lidhura me shqiptarët si identifikues të ngjarjeve me shenjtorë kishin rolin e një garancie besueshmërie për dëgjuesit sllavë: “përderisa ngjarja kishte ndodhur në Durrës / apo në qytetin e atyre që dinin/njihnin/flisnin shqip, me siguri që ishte e vërtetë e duhej besuar”.

BIBLIOGRAFI

De Santos Otero, Aurelio. *Die Handschriftliche Überlieferung der Altslavischen Apokryphen*, band II, Walter de Gruyter: Berlin/New York, 1981.
Demiraj, Bardhyl. "Shqiptar në një dorëshkrim të shek. XVII", *Shejzat* 1-2, 2022, f. 7-19.
Dimnik, Martin. "Kievan Rus', the Bulgars and the Southern Slavs, c. 1020-c.1200", në D. Luscombe, J. Riley-Smith (bot.), *The New Cambridge Medieval History. Vol. IV c. 1024-c. 1198. Part II*. Cambridge: Cambridge University Press, 2004, f. 254-276.
Ducellier, Alain. *La façade maritime de Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XIe siecle au XVe siècle,* Institute for Balkan Studies, monograph 117, Thessalonike, 1981.
Dvornik, Francis. *The slavs, their early history and civilization*, Boston: American Academy of Arts and Sciences, 1959.
Elsie, Robert. *A Dictionary of Albanian Religion*, New York University Press: New York, 2001.
Farlati, Daniele; Coleti, Jacopo. *Illyrici sacri. Tomus VII. Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis, et Sirmiensis, cum earum suffraganeis*, Venettis: Sebastianum Coleti, 1817.
Fedalto, Giorgio. *Acta Eugenii Papae IV (1431-1447), e Vaticanis Aliisque Regestis Collegit Notisque Illustravit*. Fontes, Series III, Volumen XV, Romae 1990.
Ferluga, Jadran. *Byzantium on the Balkans. Studies on the Byzantine Administration and the Southern Slavs from the VIIth to the XIIth Centuries*, Amsterdam: A. M. Hakkert, 1976.
Fine, John V. A. *The Early Medieval Balkans. A Critical Survey from the Sixth to the Late Twelfth Century*, Ann Arbor: University of Michigan Press, 1991.
Gautier P. (përkth..), *Théophylacte d'Achrida, Lettres*, Thessalonique: Association de recherches byzantines, 1986.
Historia I. Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar I. Ilirët, mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX*, Tiranë: Toena, 2002.
Ivanov, Sergey. "The Legend of the Twelve Fridays and 'Quattuor Tempora'", *Scrinium* 9, 2013, f. 185-206.

Ivanov, Sergey. "The Legend of the Twelve Fridays in the Russian and Irish Traditions: An Attempt at Contrastive Analysis", *Studia Celto-Slavica* 7, 2015, f. 105-116.
Ivanov, Sergey. "Anti-Jewish polemics and the texts on Friday fasts", *Literaturwissenschaftliches Jahrbuch* 57, 2016, f. 87-112.
Le Quiens, Michel. "Oriens Christianus", në *Quatuor Patriarchatus Digestus,* tomus secundus, Parisiis 1740.
Lourié, Basil. "Friday Veneration in Sixth-and Seventh-Century Christianity and Christian Legends about the Conversion of Nağrān", në C. A. Segovia, The Coming of the Comforter: When, Where, and to Whom? Studies on the Rise of Islam and Various Other Topics in Memory of John Wansbrough, Georgias Press 2012, f. 131-230.
Lourié, Basil. "Slavonic Pseudepigrapha, Nubia, and the Syrians", në T. Nicklas, C. R. Moss, C. M. Tuckett, J. Verheyden (bot.), *The Other Side: Apocryphal Perspectives on Ancient Christian "Orthodoxies"*, *Novum Testamentum et Orbis Antiquus 117,* Göttingen: V&R 2017, f. 225-250.
Malalas. E. Jeffreys, M. Jeffreys, R. Scott (përkth.), *The Chronichle of John Malalas*, Melbourne: Australian Association for Byzantine Studies, 1986.
Miltenova, Anissava; Angusheva-Tihanov, Adelina. "Editing slavonic texts with fluctuating traditions: the casse of the South Slavonic Copies of 'The account of the Twelve Fridays'", në L.M.E. Sels, J. Fuchsbauer, V.S. Tomelleri (bot.), *Editing medieval texts from a differnt angle. Slavonic and multilingual traditions ...,* Leuven 2018, f. 349-378.
Nesbit, John W.; Oikonomides, Nicolas. *Catalogue of Byzantine seals at Dumbarton Oaks and in the Fogg Museum of Art I. Italy, North of the Balkans, North of the Black Sea*, Washington, 1991.
Oikonomides, Nikolas. *Les listes de préséance byzantine des IXe et Xe siècles. Introduction, texte, traduction et commentaire*, Paris: Editions du Centre National de la Recherche Scientifiques, 1972.
Payne Smith, Robert. *Thesaurus Syriacus*, tomus II, Oranii 1901.
Porphyro. *DeAdministrando*: G. Moravcsik, R. J. H. Jenkins (përkth.), *Constantine Porphyrogenitus, De administrando Imperio*, Washington, 1967.

Prigent, Vivient. "Notes sur l'évolution de l'administration byzantine en Adriatique (VIIIe-IXe siècle)", *Mélanges de l'École française de Rome. Moyen Âge*, 120/2, 2008, f. 393-417.
Procopii Caesariensis. *De Bello Vandalico*, në *Ilirët dhe Iliria te autorët antik*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, 2002, f. 430-431.
Saint Augustine's Abbey, *The Book of Saints*, A&C Black: London, 1921.
Šufflay, von Milan. "Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme", në L. von Thallózy, (bot.), *Illyrisch – Albanische Forschungen*, vol. I, München-Leipzig 1916, f. 188-281.
Shehi, Eduard. *Topografia e Durrësit mesjetar*, Akademia e Studimeve Albanologjike: Tiranë, 2022.
Thalloczy, Lajos; Jireček, Constantin. *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, Annos 344-1343. Vol. I. Vindobona: Typis Adolphi Holzhausen, 1913.
Treadgold, Warren T. *Byzantium and Its Army*, Stanford, California: Stanford University Press, 1995.
Valli, Riccardo.*Vita et obitus beate Arthellays uirginis. Testo, traduzione, commento*, Centro Culturale per lo studio della civiltà contadina nel Sannio: Campolattaro, 2019.
Živković, Tibor. "Uspenskij's Taktikon and the Theme of Dalmatia", *Byzantina Symmeikta* 17, 2005, f. 49-85.
Xhufi, Pëllumb. *Dilemat e Arbërit. Një studim mbi Shqipërinë e shek. XI-XVI*, Tiranë: Pegi, 2006.

SAINT ELEUTHERIUS, DURRËS, AND THE ETHNONYM "SHQIPTAR"

Summary

The article analyzes the connection between Durrës and Saint Eleutherius according to the manuscripts "Skazanie o 12 Pjatnicach" in Old Slavonic. The toponym of the city where a debate between the saint and a Jew occurred is given as "Šeptail" (third quarter of the 13th century) or "Drač" (14th century). The root of the toponym is thought to have been /š/-/p/-/t/-/l/. One proposal for its interpretation identifies the ethnonym "shqiptarë" (Albanians) according to the Slavic version "šiptar".

The mention of Durrës in Slavic religious manuscripts is linked to the key position it held in the spread of Christianity among the Slavs since the end of late antiquity. This position also explains the possible use of the ethnonym "shqiptar", or the root of the word from which the ethnonym might have later been created. The use of toponyms or ethnonyms related to Albanians seems to have served as a guarantee of credibility for the Slavic listeners: "since the event happened in Durrës / in the city of those who knew/spoke Albanian, it was certainly true and should be believed."

Keywords: Saint Eleutherius, Durrës, Christianity among Slavs, ethnonym "shqiptar"